



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

**GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS EITI SHQIPËRI
SEKRETARIATI I NISMËS PËR TRANSPARENCË
NË INDUSTRIJË NXJERRËSE
EITI SHQIPËRI**

**FTESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR PJESËMARRJE TË
SHOQATAVE APO INDIVIDËVE, PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË
CIVILE, NË GRUPIN NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS NISMA PËR
TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE EITI SHQIPËRI**

Nisma për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse – EITI (këtej e tutje EITI) është një iniciativë ndërkombëtare që ka në objekt të saj të zhvillojë dhe implementojë një mekanizëm për të bërë deklarimin e të ardhurave që vilen nga përdorimi i Burimeve Natyrore nëpërmjet Industrive Nxjerrëse, publikimin e këtyre të dhënave në një format të kuptueshëm nga të gjithë dhe mbikqyrjen e tyre në mënyrë që ti mundësojë publikut të gjerë të ketë informacion për sa i përket të ardhurave si dhe shpenzimeve publike, duke kontribuar kështu në një debat publik dhe krijimin e mekanizmave për mirëadministrim e këtyre të ardhurave në dobi të komuniteteve. Proçesi i EITI-t mund të dimensionohet më tej dhe të përshtatet sipas kontekstit aktual të çdo vendi zbatues, për të përmbushur nevojat informative të palëve të interesuara si dhe nevojat për të prekur sektorin me reforma të rëndësishme bazuar në këto të dhëna. Siç përcaktohet në Kërkesat e Standartit EITI. Implementimi i Standartit EITI kërkon mbikëqyrje efektive të procesit EITI nga të gjitha grupet e interesit. Kjo realizohet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Grupi me Shumë Aktorë (këtej e tutje MSG), në të cilin përfshihen përfaqësues të qeverisë, kompanive që operojnë në këtë sektor dhe pjesëmarrjes së plotë, të pavarur, aktive dhe efektive të shoqërisë civile, të cilët angazhohen të punojnë së bashku për të zhvilluar e promovuar transparencën dhe mirëqeverisjen e këtij sektori.

Në kuadër të implementimit të Nismës për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse - EITI Shqipëri, në përgjigje të zbatimit të Standardit Ndërkombëtar EITI dhe në mbështetje të *Urdhrit të Kryeministrit Nr. 71, dt 21/07/2011 "Mbi funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës si vend zbatues i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse"*, Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG Shqipëri) punon si strukturë drejtuese dhe koordinuese për çështjen EITI në Shqipëri.



MSG-ja është organi vendimmarrës, i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI-it në Shqipëri. Ky grup drejtohet nga Zëvendësministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe përbëhet 16 përfaqësues, 6 nga institucionet shtetërore, 5 nga kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse dhe 5 nga shoqëria civile. Grupi Ndërinstitucional i Punës, miraton planin e punës për sekretariatit, paraqitjen e raportit vjetor EITI, siguron që EITI të kontribuojë në debatin publik dhe mbështetet punën e Sekretariatit Shqiptar EITI.

Mbështetur në nenin 10, të “RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS (MSG) NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË ORGANIZMIN NDËRKOMBËTAR EITI- INTERNATIONAL”, miratuar me Udhërin e Ministrisë, Nr. 454 Prot, Datë 30. 12. 2016 “Urdhër për Miratimin e Rregullores së Grupit Ndërinstitucional të Punës (MSG), në Kuadër të Antaresimit në Organizmin Ndërkombëtar EITI International, Kryetari i MSG-së Shqiptare, Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Enis Aliko, fton të gjitha shoqatat dhe individët, përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri, të përzgjedhur nga Grupime Kombëtare të Shoqërisë Civile, Gazetarë, figura të shquara akademike, Grupime të pavarura ekspertesh të sektorit (thinktanks) si dhe grupime të sindikatave, me shtrirje të gjerë gjeografike.

Proçesi i përzgjedhjes për përfaqësuesit e OSHC-ve në MSG përcaktohet bazuar në proçesin zgjedhor të përshkruar në “Kodin e Sjelljes së OSHC-ve të përfshira në proçesin EITI” dhe administrohet në mënyrë të pavarur dhe transparente nga grupimi i Shoqërisë Civile.

Për sa më sipër, të gjithë grupimet e Shoqërisë Civile, apo individët e sipërpërmendur, të interesuar për tu bërë pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës EITI Shqipëri, duhet të dërgojnë me email një CV dhe një Shprehje Interesi në adresat e emailit të poshtëshënuara brenda datës **28 Janar 2019**.

Kandidaturat e paraqitura do të vlerësohen dhe përzgjidhen në bazë të dokumentacionit të përmendur më sipër.

*Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)
Në vëmendje të: Z. Ardit Kamberi, Drejtues i Sekretariatit Shqiptar EITI*

Email: anilahajnaj@gmail.com

Cc: ardit.kamberi8@gmail.com

emiliana.kola@albeiti.gov.al

KRYETAR I MSG EITI ALBANIA
dhe
ZV/MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

ENIS ALIKO

